Kronikë

E rëndë në Durrës/ 19-vjeçarja vret me armë babanë: Më nxiste për tu fejuar pa dëshirë! Trupi gjendet pas 10 ditësh i varrosur në oborr (VIDEO)

Një 19-vjeçare në Durrës ka vrarë me armë zjarri të atin dhe më pas e ka varrosur në kasollen e lopës. Vrasja ka ndodhur më 13 shkurt dhe 50-vjeçari është gjetur pas 10 ditësh i varrosur, pas denoncimit të djalit se ka humbur kontaktet me të atin. E reja, studente e Ekonomikut, ka deklaruar se i ati e ka detyruar të fejohet pa dëshirën e saj.

- Arma s'është gjetur, dyshime se 19-vjeçarja u ndihmua nga persona të tjerë
- DETAJET/ E lidhi, e mbështolli me batanije dhe e varrosi në oborr
- Ja vendi ku 19-vjeçarja varrosi babanë pasi e vrau
- Të afërmit: Të tronditur, nuk dinim asgjë

Redaksia
23 Shkurt, 08:55 | **Përditesimi: 23 Shkurt, 10:18**

Share

DURRËS- Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Durrës. Një 19-vjeçare ka vrarë me armë zjarri babanë e saj në kasollen e lopës dhe më pas e ka varrosur në oborrin e banesës.

Vrasja ka ndodhur më datë 13 shkurt 2024 në fshatin Shënavlash, dhe 50-vjeçari Pëllumb Meta ka qenë i varrosur për 10 ditë në oborr.

Ka qenë denoncimi i njërit prej djemve që ka humbur kontaktet me babanë duke zbuluar më pas ngjarjen e rëndë

[Sh].com

LEXO EDHE:
Iu konfiskua ish kryeprokurorit Adriatik Llalla, apartamenti në plazhin e Durrësit kthehet në qendër sociale për art dhe aktivizëm

E reja, studente e Ekonomikut, ka deklaruar në polici se i ati e kishte detyruar që të fejohet pa dëshirën e saj. Ngjarja po hetohej prej 10 ditësh nga Sektori i Krimeve të Rënda në Policinë e Durrësit.

Policia njoftoi sot arrestimin e 19-vjeçares Hygerta Meta, e cila është studente në Tiranë në administrim biznes. Trupi i 50-vjeçarit është zhvarrosur dhe është transportuar në Institutin e Mjekësisë Ligjore, për kryerjen e ekspertizës së mëtejshme.

> *"Gjithashtu, nga hetimet dyshohet se autore e vrasjes së 50-vjeçarit është vajza e tij, shtetasja Hygerta Meta, 19 vjeçe, e cila është arrestuar për veprën penale "Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare". Shtetasja Hygerta Meta ka deklaruar se motivi i vrasjes ka qenë nxitja prej babait, për t'u fejuar pa dëshirën e saj, si dhe konfliktet familjare që kanë patur", njoftoi sot policia.*

Raportojnë për Report Tv dhe Shqiptarja.com gazetarët Aldo Mustafa dhe Artur Korriku, Sokol Dema.

Ndiqni lajmet në zhvillim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:08

19-vjeçarja që vrau babanë studente Ekonomiku, e qëlloi me pistoletën pa leje që mbante i ati (Dyshimet)

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



Detaje të reja janë mësuar në lidhje me ngjarjen e rëndë që ka ndodhur në Shënvlash të Durrësit, ku 19-vjeçarja Hygerta Meta ka vrarë me armë zjarri babain e saj Pëllumb Meta.

19-vjeçarja ishte studente në Tiranë në administrim biznes, ka marrë përsipër autorësinë e krimit, ndër to dhe dërgimin e automjetit të babait në zonën e plazhit.

Vrasjen e të atit e ka kryer me pistoletën e viktimës që e mbante pa leje por policia ende nuk ka mundur të sekuestrojë armën dhe as gëzhojat, të cilat po ashtu ka deklaruar se i ka hedhur në zonën e sektor Rinia. Viktima i ati punonte si roje.

Policia e Durrësit po verifikon edhe rolin e të ëmës së 19-vjeçares dhe 2 vëllezërve të saj në ngjarjen e rëndë në familje.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:00

Vrasja në Durrës/ FOTO e 19 vjeçares studente dhe babait të vrarë



Shqiptarja.com siguron foton e viktimës dhe 19 vjeçares e cila akuzohet se vrau të atin.

Ngjarja e rëndë ka ndodhur në Durrës. Studentja ka vrarë me armë zjarri babanë e saj në kasollen e lopës dhe e ka varrosur në oborr.

Viktima është Pëllumb Meta, ndërsa vajza e arrestuar është Hygerta Meta.

Dyshohet se ajo ka bashkëpunuar me persona të tjerë

S.G/Shqiptarja.com

Share

Ora 09:57

19-vjeçarja vrau të atin, të afërmit: Të tronditur, nuk dinim asgjë! E morëm vesh lajmin nga televizori

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Durrës, ku një 19-vjeçare ka vrarë të atin dhe e ka varrosur me pas në oborrin e banesës. Dinamika e ngjarjes është ende e paqartë, ndërsa vetë vajza ka deklaruar në Polici se e ka vrarë të atin, pasi ai e detyronte që të fejohej pa dëshirë.

Familjarët thonë se janë shumë të tronditur dhe se nuk dinin asgjë.

> *"Nuk di asgjë. Shumë i tronditur. Është traditë e shqiptarit njoftojmë njëri tjetrin për fatkeqësi. Nuk e di si e ka bërë", tha një familjar.*
>
> *"Ne e kemi marrë lajmin nëpërmjet televizorit", tha një tjetër i afërm.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:53

Ja vendi ku 19-vjeçarja varrosi babanë pasi e vrau në Shënvlash të Durrësit



Report Tv sjell pamjet nga vendi ku 19-vjeçarja Hygerta Meta varroi të atin Pëllumb Meta pasi e vrau me armë zjarri, sepse sipas saj po e detyronte që të fejohej pa dëshirën e saj.

E reja dyshohet se e ka mbështjellë me batanije dhe e ka varrosur babin në oborrin e banesës në një tokë që siç duket është e punuar.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:48

19-vjeçarja vrau babanë, drejtori i Policisë së Durrësit mbërrin në vendin e ngjarjes

Drejtori i policisë së Durrësit, Skënder Hitaj ka mbërritur në vendin e krimit në Durrës, në banesën ku 19-vjeçarja ka vrarë bababë.

Në foton që sjell Report Tv dallohet edhe momenti kur Hitaj mbërrin në vendin e ngjarjes.

Vrasja ka ndodhur më 13 shkurt dhe 50-vjeçari Pëllumb Meta ka qenë i varrosur prej 10 ditësh në kasollen e lopës.

Policia ka dyshime se e reja Hygerta Meta nuk ka vepruar e vetme, por është ndihmuar edhe nga persona të tjerë. Grupi hetimor nën drejtimin e drejtorit Hitaj po punon për zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:39

19-vjeçarja vrau babanë, Report Tv sjell pamjet nga banesa në Durrës! Policia në vendngjarje

Report Tv sjell pamjet nga banesa në Durrës, ku 19-vjeçarja Hygerta Meta vrau me armë zjarri babanë e saj 50-vjeçar. E reja pasi e ka vrarë babanë e ka lidhur, mbështjellë me batanije dhe e ka varrosur në oborr.

Siç shihet edhe në këto pamje, policia dhe grupi hetimor ndodhet në vendin e ngjarjes.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:23

19-vjeçarja vrau babanë, policia dyshon se ka dhe persona të tjerë të përfshirë! Arma s'është gjetur ende

Një ngjarje e rendë ka ndodhur në Durrës pasi një 19-vjeçare, Hygerta Meta është arrestuar dhe dyshohet se ka vrarë babanë e saj Pëllumb Meta, të cilin më pas e ka varrosur në oborr.

Ndërkohë policia ka shumë pikëpyetje për të vërtetën e kësaj ngjarje, pasi arma e krimit ende nuk është gjetur.

Dyshimet janë se mund të ketë edhe persona të tjerë të implikuar në krim kjo duke u nisur nga dinamika e ngjarjes e cila ende ka pika të dyshimta.

Vajza ka thënë se ka qenë ajo që e ka çuar makinën e babait në sektorin Rinia.

M.Q./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:22

DETAJET/ Si e vrau vajza babanë në Durrës! E lidhi, e mbështolli me batanije dhe e varrosi në oborr



Report Tv sjell të tjera detaje nga vrasja në Durrës, ku 19-vjeçarja vrau me armë zjarri të atin Pëllumb Meta. Ky i fundi punonte roje në tregun e makinave, ndërsa vajza ishte studente në shkollë të lartë.

Hetimet për gjetjen e 50-vjeçarit kanë nisur pasi kallëzimit të djalit se babai ishte larguar nga shtëpia dhe nuk ishte kthyer policia u vu në lëvizje.

Vrasja ka ndodhur më 13 shkurt, gjatë hetimeve agjentët gjetën makinën e tij në sektorin Rinia të braktisur. Këtu nisën dhe dyshimet e para për fatin e burrit.

Disa familjarë janë marrë në pyetje, deri kur vajza ka pranuar autorësinë e krimit. Ajo ka deklaruar se e ka vrarë të atin në kasollen e lopës, e kishte lidhur, mbështjellë me batanije dhe varrosur në oborr.

Ka qenë 19-vjeçarja Hygerta Meta që ja tregoi policisë vendin se ku gjendej babai i vdekur.

Familja përbëhet nga 2 prindërit, 4 fëmijë prej të cilëve 2 djem dhe 2 vajza. Njëra vajzë e martuar.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./S.G/Shqiptarja.com

TAG: Durres | Hygerta Meta | pellumb meta | vrasje

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Kuvendi miraton ndërtime strategjike në zonat e mbrojtura, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Punimet për linjën hekurudhore, sot në orën 22:00 bllokohet qarkullimi automjeteve në Rrashbull! Mjetet do duhet të përdorin aksin Tiranë-Durrës

22 Shkurt, 16:04



Arrestohet në Durrës 'Çipuri', ish anëtari i bandës së Gaxhait në Vlorë tentoi t'i ikte policisë! Në kërkim bashkëpunëtori

22 Shkurt, 10:44

Ndalohet në kufi i deportuari nga Spanja dhe kosovarja e dënuar për falsifikim vizash, sekuestrohen 20 mijë euro e 15 mijë paund

22 Shkurt, 10:12

E rëndë në Kumanovë, 66 vjeçari vret motrën dhe nipin e tij pas konflikteve për pronën

21 Shkurt, 16:25

Kastrioti fiton me Bylisin, hapet gara për kreun e Kategorisë së Parë! Krutanët shanse për mbijetesën

21 Shkurt, 16:02

Merret vendimi/ Porti i ri tregtar i 'Porto Romanos' me kosto 422 mln euro do ndërtohet me fonde të buxhetit të shtetit

Eliza Gjediku

21 Shkurt, 15:04

Durrës, ezaurohet sipërfaqja në qytet, ndërtimet shtrihen drejt Currilave dhe Kallmit! Çmimi i apartamente në plazh 1800 euro/m2

Artur Korriku

21 Shkurt, 13:08

Të pastrehët në protestë, tensione para bashkisë në Durrës! Banorët: S'marrim bonus qiraje prej 10 muajsh

Aldo Mustafa

20 Shkurt, 15:01



'Me një plumb humbën dy jetë', lihet në burg shqiptari që vrau të dashurën në Greqi! Çifti po planifikonte martesën

20 Shkurt, 13:23

'Tempulli 2'/ Në kërkim për shitje dhe prodhim droge, pranga 32-vjeçarit në Durrës

20 Shkurt, 11:04

Fushë-Krujë/ Dhunë në Kategorinë e Dytë të futbollit, Murlani: Na ndaluan të festonim, tifozët u futën në fushë nga të gjitha anët (VIDEO)

18 Shkurt, 17:04

Durrës/ Dhunuan gratë e tyre dhe kundërshtuan punonjësit e policisë, arrestohen tre burra

18 Shkurt, 11:29

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje